



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:074334

Datë: 26.01.2023

Numri i dokumentit: 03907537

P.nr.141/18

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Hoxha, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. H. nga fshati Denjë, komuna Rahoveci, për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve komunal nga neni 320 të KPRK¹-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.401/2018 të datës 16.03.2018, jashtë seancës, më datën 26 Janar 2023 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.401/2018 të datës 16.03.2018.
- II. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit *M. H.*, i lindur më datë ... në fshatin Dejné, komuna Rahovec, nga i ati A., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i ngarkuar me veprën penale *Vjedhja e shërbimeve komunal nga neni 320 të KPRK-së*, **për shkak të vdekjes**.
- III.** Pala e dëmtuar, K.-Distrikti Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.
- IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.nr.401/2018 të datës 16.03.2018, kundër të akuzuarit M. H. nga fshati Denjë, komuna Rahoveci, për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve komunal nga neni 320 të KPRK-së*.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës, PP.nr.401/2018 të datës 16.03.2018, ka caktuar një sërë seanca gjyqësore-fillestare.

¹ Kodi Penal I Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082.

Gjyqtari i rastit me të pranuar lëndët nga gjyqtari paraprakë, ka caktuar seancën gjyqësore- fillestare më datë 12.01.2023, ku nga fletëkthesa e gjykatës e datës 29.12.2022 është konstatuar se “*pala i vdekur familja nuk pranoj ftesën*”.

Gjykata përmes kërkesës së datës 12.01.2023, nga Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, ka kërkuar që të verifikoj faktin se i pandehuri a është i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile për të vdekur, nga Drejtoria për Administratë pranë Komunës së Rahovecit, gjykata është njoftuar se “*M. H. i lindur më datë ... në Dejnë, me numër personal ..., në Zyret e Gjendjes Civile, nuk është lajmruar vdekja, ndërsa në sistemin e gjendjes civile është raportuar nga Bashkia Fetare si i vdekur*”.

Tutje gjyqtari i vetëm gjykues, më datë 12.01.2023 ka lëshuar Urdhëresë për Stacionin policor në Rahovec, që të verifikoj faktin mbi vdekjen e të pandehurit M. H. nga fshati Denjë, Komuna Rahovec.

Nga raporti i Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Rahovec i datës 18.01.2023 më numër të referencës 04/1-08/R:28/23, gjykata është njoftuar se: “*Stacioni Policor në Rahovec është angazhuar në zbatimin e Urdhëresës me numër P.nr.141/18 për verifikimin dhe vendqëndrimin e të pandehurit M. A. H., dt.... fshati Dejnë, me që patrulla policore kishte kontaktuar me bashkëfshatarin (H. D. B. dtl.01.05.1991, po ashtu janë siguruar informata nga anëtarët të familjes të cilët kanë deklaruar se i akuzuari, tash më i ndjeri M. A. H. ka vdekur më datë ...*”, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, kjo për faktin se ka rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale, prandaj në pajtim me nenin 160 dhe nenin 358 par.1 nën-paragrafi 1.3 KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

- Divizioni Penal -

P.nr.141/18; datë 26 Janar 2022

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Hoxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.